



Gazeta "Ekologjistët e vegjël"



Shkolla "Ismail Kasa" është një ndër shkollat që bën pjesë në planin e veprimtarive të organizatës Save the Children in Albania. Falë bashkëpunimit me Save the Children in Albania së bashku me nxënësit, shkolla "Ismail Kasa" ka bërë një përmirësim lidhur me gjelbërimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të shkollës. Organizata Save the Children in Albania na ka ndihmuar me shume fondacione të cilat i kemi përdorur për të gjelbëruar ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës me lule dhe pemë, ka ndihmuar me mjete të cilat nxënësit mund

t'i përdorin në veprimtari të ndryshme. Për të kuptuar më tepër vazhdoni dhe lexoni materialin e përgatitur:

Fjalë zemre...!


Në shumicën e rasteve ose madje edhe gjithmonë, ndihma është gjëja më e madhe që lumturon çdokënd. Kjo përfshin aspektin e të ndihmuarit në përgjithësi, pasi të gjithë njerëzit mund të ndihmojnë në forma të ndryshme, jo vetëm nga ana ekonomike, por gjithashtu edhe nga ana shpirtërore.

Ky mesazh vlen posaçërisht për organizatën Save the Children. Ne, nxënësit e shkollës "Ismail Kasa" të qytetit të Elbasanit, ju falenderojmë nga thellësia e zemrës për këtë kontribut kaq të madh që keni dhënë pa hezitim. Kur flitet për këtë organizatë, emocionet tonajane të pashmangshme dhe gjithashtu gëzimi duken qartë në sytë tanë, por ky nuk është një falenderim i thjeshtë, por një falenderim që buron nga thellësia e zemrës. Mbështetja juaj na ka frymëzuar

gjithmonë dhe madje na mbush zemrën me lumturi. Humanizmi juaj na ka ndihmuar që të jemi më të ndjeshëm ndaj nevojave dhe sesi ne duhet të ndihmojmë ata që kanë nevojë për ndihmë. Këshillat dhe mesazhet tuaja të sinqerta, sensibilizuese dhe të ndritshme na i keni ngulitur në mendjen tonë, janë gjithmonë një ndihmë e madhe për ne, duke na keni frymëzuar nëpërmjet veprave tuaja të mira. Një falenderim i sinqertë për organizatën Save the Children in Albania, e cila është bërë pjesë e zemrave njerëzore. Një ndër këshillat tuaja është ta duam e ta mbrojmë Tokën dhe me të vërtetë "NE E DUAM TOKËN".



Për një mjedis të gjelbër...!



të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë.

Gjithashtu nxënësit e shkollës ekologjike kanë përgatitur postera e fletëpalosje për t'i treguar të tjerëve

Një ndër veprimtaritë që kanë ndërmarrë nxënësit e shkollës "Ismail Kasa" është edhe hartimi i një rregulloreje mbi kujdesin dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo rregullore përmban rregulla të cilat janë

se të gjithë ne, me vepra të vogla sensibilizuese mund ta mbrojmë Tokën. Këtë mesazh ata nuk e kanë percjellë vetëm tek nxënësit e tjerë të shkollës por edhe në komunitetin përreth.

Me ndihmën e organizatës Save the Children në shkollën tonë janë mbjellë shumë lule dhe pemë. Shkolla jonë është bërë akoma më e bukur tani që është gjelbëruar. E pra me thoni: - **Cili krijim i natyrës nuk është i bukur? Të gjitha krijimet e natyrës janë të bukura dhe prandaj ne nuk duhet t'i dëmtojmë ato.**

Riciklo edhe ti!



Nxënësit e shkollës ekologjike me mjete te riciklueshme kanë krijuar edhe makete të ndryshme për t'u treguar të gjithëve, se si do të ishte bota nëse ne nuk do ta shkatërronim atë. Ne njërin prej maketeve është qyteti ekologjik i cili është i gjelbëruar me bimë dhe me sa fat do të ishim ne, nëse qyteti i Elbasanit do të ishte kaq shumë i gjelbëruar, ndërsa në maketin tjetër është krijuar një ujëvarë e rrethuar nga një pyll i cili tregon se sa e bukur është Toka nëse ne nuk e shpyllëzojmë atë.



Ndryshimet klimatike shqetësojnë banorët e zonës!

(Intervista e bërë me një banore të fshatit Bujqës)

Intervistuesja: - Përshëndetje zonjë, më falni mund t'ju bëj disa pyetje?

Zonja: - Përshëndetje, po me shumë kënaqësi!

Intervistuesja: - Si ju duken moti këto ditë?

Zonja: Këto kohët fundit po më duket sikur është "çmendur", nuk po dallojmë dot as stinën në të cilën ndodhemi. Madje edhe klima ka ndryshuar shumë. Stinët e bukura të klimës sonë mesdhetare nuk po i dallojmë dot më.

Intervistuesja: - Dmth ju po më shprehni se veçoritë klimatike kanë ndryshuar nga ato që po shfaqen tani?

Zonja: - Po, kanë ndryshuar shumë, para disa vitesh çdo stinë kishte kohëzgjatjen e saj të caktuar dhe ne e dinim, që me fillimin e muajit mars niste edhe stina e pranverës e kështu me radhe çdo stinë fillonte e mbaronte në muajt e saj. Ndërsa sot nuk ndodh kështu, ne nuk arrijmë të kuptojmë dot në cilën stinë jemi. Stinët kanë humbur radhën dhe tiparet e tyre karakteristike.

Intervistuesja: Si mendoni ju cili është shkaku kryesor që po ndodh kjo dukuri?

Zonja: - Ah bija ime, ne jemi ne, ne po e vrasim mjedisin dita-ditës, me ndotjen që po i shkaktojmë, me mbeturinat që i hedhim vend e pa vend, me mbeturinat që i hedhim para derës së komshiut, me pyjet që presim për të hapur toka apo për të ndërtuar resorte, ne që po betonizojmë çdo cep të mundshëm.

Intervistuesja: - A ju shqetëson ju ky ndryshim klimatik dhe kjo ndotje kaq e lartë e mjedisit?

Zonja: - Po më shqetëson shumë. Unë dhe familja ime të ardhurat tona i sigurojmë nga toka, pra bujqësia sepse merremi me kultivimin e perimeve. Ndryshimet klimatike dhe ndryshimet e menjëhershme të temperaturave ndikojnë drejtpërdrejtë të prodhimit e perimeve të stinës. Kandodhur mjaft raste që l gjithe prodhimi i serës është dëmtuar dhe ne nuk kemi arritur të mbulojmë dot as shpenzimet.

Një problem tjetër për ne është edhe Metalurgjia, e cila na ndikon drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit për faktin se shumë fabrika punojnë ende pa filtrat e ajrit.

Intervistuesja: - Do doja të dija mendimin tuaj në lidhje me aktivitetet sensibilizuese që po zhvillon shkolla jonë, për sa i përket mbrojtjes së mjedisit?

Zonja: - Shkolla ka filluar të marrë më tepër gjallëri, kam vënë re që këni shtuar bimë dhe lule të ndryshme e që po kujdeseni për to, pastroni vazhdimisht shkollën duke dhënë një shembull shumë pozitiv. Ju përgëzoj! Madje shoh që jeni organizuar shumë mirë nxënës dhe mësues, nëpërmjet veprimtarive dhe aktiviteteve të ndryshme. Uroj që të vazhdoni në këtë mënyrë për t'i dhënë jetë shkollës dhe një mundësi zhvillimi zonës sonë. Ju jeni e ardhmja jonë, nga ju i kemi sytë dhe shpresat se do ta bëni më mirë këtë vend!

Intervistuesja: - Ju falenderoj shumë për kohën tuaj!

Zonja: - Faleminderit edhe ty, të uroj suksese!



Fakt interesant...!

A e dini se ndotja e ajrit ndikon tek bullizmi...?!

Një studim relativisht i ri zbuloi se frymëmarrja e ajrit të ndotur është e lidhur me sjelljet agresive dhe sulmet tek të rriturit. Ai vlerësoi faktin se ndotja e ajrit ndikon drejtpërdrejtë te gjendja emocionale dhe psikologjike e individëve. Njerëzit që jetojnë në vende me një nivel të lartë ndotjeje janë më të prirur për të bullizuar se sa njerëzit që jetojnë në mjedise të gjelbëruara e më pak të ndotur. Njerëzit në këto vende e manifestojnë pakënaqësinë e tyre nëpërmjet sjelljeve agresive që tregojnë ndaj njëri-tjetrit.